



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2022:079940
Datë: 21.08.2024
Numri i dokumentit: 06072865

P.nr.168/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË VITI / Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me bashkëpunëtoren profesionale Kadishe Ajvazi Demi, në çështjen penale ndaj të pandehurit Z.M...nga fshati G..., komuna e V..., për shkak të veprës penale Keqtrajtim gjatë detyrës ose autorizimeve publike nga neni 195 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-s), të cilin e mbron sipas detyrës zyrtare av. Skender Shefkiu, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.587/22, të datës 22.04.2022, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar publik, më datë 08.08.2024, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **Z.M...**, nga babai H... dhe nëna Sh..., e gjinisë H..., i lindur më datë ..., në fshatin G..., komuna e V..., ku edhe jeton, ka të kryer fakultetin juridik, i punësuar në ..., i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, baba i tre fëmijëve, me numër personal 1..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 01.04.2022, rreth orës 15:00, në objektin e Qendrës për Punë Sociale, në Viti, i pandehuri Z.M..., në cilësinë e personit zyrtar të Q...në V..., gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare dhe autorizimeve publike, ka keqpërdorë detyrën dhe autorizimet zyrtare, në atë mënyrë që, ditën kritike në takimin e paraparë të fëmiut 7 (shtatë) vjeçar, A.A..., me nënën e tij biologjike L.M..., e divorcuar nga ish bashkëshorti J.A..., i pandehuri shkon te vetura për ta marrë fëmiun, në automjete i cili ishte së bashku me babain e tij, ndërsa nëna e fëmiut ishte duke pritur brenda qendrës sociale, dhe kur fëmiu s'ka pranuar të dalë nga vetura, në ndihmë i kanë ardhur edhe disa zyrtar tjerë të qendrës sociale për ta bindur fëmiun, ku pastaj i pandehuri nga distanca fillon që ta ngritë zërin ndaj fëmiut, duke i thënë” „Unë jam doktor dil se të jap injeksion,” pas kësaj, automjeti hynë brenda oborrit të QPS dhe në automjet realizohet takimi 15 minutash i nënës dhe fëmiut, ku fëmiu ishte qetësuar dhe e kishte përqaftuar nënën e vet, mirëpo në automjet ishte prezentë edhe vajza e axhës së J.A..., e cila përmes telefonit e ka incizuar bisedën e të pandehurit me fëmiun, në këtë mënyrë i pandehuri e ka keqtrajtuar, e ka frikësuar, e ka fyer dinjitetin e fëmiut dhe ka keqpërdorë detyrën apo autorizimet e tije publike.

-me çka ka kryer veprën penale, Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 195 paragrafi 2 i KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38, 46, 47, 48, 49, 69, 70 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i shqipton,

DENIM ME KUSHT

I. Të pandehurit Z.M..., për veprën penale Keqtrajtim gjatë detyrës ose autorizimeve publike nga neni 195 paragrafi 2 të KPRK-s, i caktohet:

- **dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

II. Obligohet i akuzuari të paguaj taksën për Kompensimin e Viktimave të krimin në shumë prej 20.00 (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

III. Obligohet i akuzuari që të paguajë paguaj paushallin gjyqësor në shumën pre 20.00 € (njëzetë euro), në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1. Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 22.04.2024, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.587/2022, kundër të akuzuarit Z.M...nga fshati G..., komuna e V..., për shkak të veprës penale keqtrajtim gjatë detyrës ose autorizimeve publike nga neni 195 paragrafi 2 të KPRK-s.

Në shqyrtimin fillestar publik të datës 08.08.2024, prezent ishin prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, i pandehuri Z.M..., me mbrojtësin e tij av.Skender Shefkio, si dhe përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit të mitur - prindi J.A..., në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorës së shtetit ka deklaruar se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 242 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, prandaj ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit Z.M..., për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar as i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj vepre, ekziston fakti se i pandehuri Z.M..., ka kryer veprën penale keqtrajtim gjatë detyrës ose autorizimeve publike nga neni 195 paragrafi 2 të KPRK-s.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, ka shpallur fajtor të akuzuarin Z.M..., për shkak të veprës penale keqtrajtim gjatë detyrës ose autorizimeve publike

nga neni 195 paragrafi 2 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 69,70 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të akuzuarin Z.M..., si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se prfaqsesi ligjor i të dëmtuarit të mitur nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike, i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, kërkim faljen të dëmtuarit, më parë nuk ka kryer vepra penale dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti se i njëjti ka shkaktuar shqetsim tek i dëmtuari, rrezikshmërinë shoqërore si dhe përgjegjësinë penale.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit Z.M..., duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nën 452 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për të paguar shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor, si dhe taksën për kompensimin e viktimave të krimit sipas ligjit (LIGJI NR. 08/L-109), të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 168/2022, më datën 08.08.2024**

Bashkëpunëtore profesionale,
Kadishe Ajvazi Demi

Gjyqtari,
Behar Ymeri

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.